

**LIGJI NR. 08/L-185****PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE****KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, të mbrojë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike dhe private, individët, shoqërinë civile dhe profesionistët e tjerë përgjegjës, për të ofruar ndihmë, mbështetje, mbrojtje dhe ruajtjen e dinjitetit të viktimave të të gjitha formave të dhunës, sipas dispozitave të këtij Ligji, legjislacionit tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe konventave dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në sistemin e brendshëm juridik.

2. Ky ligj zbatohet në sistemin e drejtësisë civile dhe administrative, dhe aty ku është e aplikueshme, si masë shtesë në sistemin e drejtësisë penale për të plotësuar mbrojtjen nga format e dhunës të përfshira në këtë ligj.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. "Marrëdhënie Familjare" -marrëdhënie në mes të personave që janë apo kanë qenë të:

1.1.1. fejuar;

1.1.2. të martuar;

1.1.3. Në bashkësi jashtëmartesore;

1.1.4. Në ekonomi të përbashkët;

1.1.5. Janë prindër të përbashkët të një apo më shumë fëmijëve;

1.1.6. Përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, krushqie, adoptimi, apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajat dhe shaxhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë.

1.2. "Dhuna ndaj grave" -kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimi ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojë në ose ka të ngjarë të rezultojë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik apo vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private;

1.3. "Dhuna në familje" - nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda marrëdhënies në familje, ose njësisë shtëpiake, pavarësisht nga lidhja e gjakut apo marrëdhënies familjare, ose nga ish- partneri intim ose partneri intim aktual, pavarësisht nga fakti nëse ushtruesi i dhunës ndan apo ka ndarë të njëjtin banim me viktimën me qëllim të cenimit të dinjitetit dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm dhe pozitë varësie, personat ndaj të cilëve është ushtruar dhuna;

1.4. "Dhunë me bazë gjinore ndaj grave"- do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje sepse është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave i përfshin shkaqet dhe rezultatin e marrëdhënies së pabarabartë të forcës ndërmjet grave dhe meshkujve si rezultat i një problemi social e jo individual;

1.5. "Ngacmimi politik" - ngacmimi politik është një ose disa veprime të presionit, persekutimit, ngacmimit ose kërcënimeve, të kryera nga një person ose grup njerëzish, drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta, ndaj grave kandidate, të zgjedhura, të caktuara ose në ushtrim të funksionit politiko-publik ose kundër familjeve të tyre, me qëllim të shkurtimeve, pezullimit, parandalimit ose kufizimit të funksioneve të qenësishme në pozicionin e tyre, për t'i nxitur ose detyruar ato të kryejnë, kundër vullnetit të tyre, një veprim ose të mos veprojnë, në kryerje të detyrave ose në ushtrimin e të drejtave të tyre;

1.6. "Dhuna Politike" - dhuna politike nënkupton veprime, sjellje dhe/ose agresione fizike, psikologjike, seksuale të kryera nga një person ose grup njerëzish, drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta, ndaj grave kandidate, të zgjedhura, të caktuara ose në ushtrim të funksionit politiko-publik; ose kundër familjes së saj, për të shkurtuar, pezulluar, parandaluar ose kufizuar ushtrimin e detyrës së saj ose për ta nxitur ose detyruar atë të kryejë, kundër vullnetit të saj, një veprim ose të mos veprojnë, në kryerjen e detyrave ose në ushtrimin e të drejtave të tyre;

1.7. "Gjini"- do të thotë rolet e ndërtuara shoqërore, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat;

1.8. "Dhunë psikologjike"- përfshinë kontrollin e vazhdueshëm, keqtrajtimin verbal, izolimin, poshtërimin apo abuzimin emocional përmes sharjes, ofendimit, shantazhit, frikësimit, përcjelljes dhe vëzhgimit të vazhdueshëm, fshehja e informacionit, dezinformimi dhe sjellja kërcënuese, trajtimin degradues, kanosjen apo format e ngjashme të kontrollit apo presionit psikik, duke e vënë një person nën frikë të arsyeshme nga përdorimi i dhunës ndaj tij apo personave në marrëdhënie familjare, kërcënimin për dëmtimin e pasurisë apo mbajtjen nën shqetësim të vazhdueshëm emocional;

1.9. "Dhunë ekonomike"- përfshin mohimin e qasjes apo kontrollit të burimeve bazike përmes kufizimit të mjeteve të domosdoshme për jetë, mohimin e qasjes në shërbime mjekësore, shkollim apo punësim, tjetërsimin e pasurisë së përbashkët para/gjatë martesës apo bashkëjetesës apo pas përfundimit të saj, apo formave tjera të presionit me qëllim të mbajtjes së një personi përbrenda një marrëdhënieje familjare në pozitë të varur ekonomike. Dhuna ekonomike mund të jetë e shprehur si formë e vetme e presionit apo e kombinuar me format tjera të keqtrajtimit apo dhunës;

1.10. "Kontrolli i vazhdueshëm" -nënkupton një sërë veprimesh që kanë për qëllim mbajtjen e një personi nën kontroll të vazhdueshëm në pozitë varësie dhe të nënshtruar përmes formave të ndryshme të dhunës apo kanosjes për dhunë, duke shfrytëzuar burimet dhe kapacitetet e tyre për përfitime personale, duke i privuar nga mjetet e nevojshme për pavarësi, rezistencë dhe largim dhe duke rregulluar sjelljen e tyre të përditshme;

1.11. "Ngacmimi seksual përmes internetit"- është një veprim i padëshiruar verbal, joverbal ose veprim tjetër i një natyre seksuale, i cili ka një qëllim ose pasojë, shkelje të dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese;

1.12. "Sindromi i personit të dhunuar"- gjendje psikologjike që mund të zhvillohet kur një person përjeton abuzim, zakonisht nga një partner intim. Ai përfshin, por nuk kufizohet në - bashkëshortët, individët që janë duke kaluar së bashku, partnerët seksualë, dhe individët që nuk kanë marrëdhënie seksuale. Marrëdhëniet nga të cilat derivon sindromi i gruas së dhunuar mund të jenë heteroseksuale ose homoseksuale;

1.13. "Partneri intim"- person me të cilin personi tjetër është apo ka qenë në lidhje të afërt personale, e ngjashme me lidhjen në çift, që mund të karakterizohet nga lidhja emocionale, kontakti i vazhdueshëm fizik apo seksual e që nuk janë ose nuk kanë qenë të fejuar, të martuar apo në bashkësi jashtëmartesore;

1.14. "Pala përgjegjëse" -personi kundër të cilit kërkohet cilado nga format e mbrojtjes të përcaktuara në këtë ligj, ose është lëshuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente;

1.15. "Viktimitë"- personi ndaj të cilit është ushtruar çfarëdo lloji i dhunës i përfshirë në këtë ligj;

1.16. "Viktimitë e ndjeshme"- vajzat dhe gratë, fëmijët, të miturit, LGBTQ +, personat me aftësitë e kufizuara fizike dhe mendore, grua shtatzënë, i/e moshuar dhe personi nga marrëdhënia familjare apo varësia e të cilit ndaj palës përgjegjëse e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit, frikësimit apo hakmarrjes së përsëritur;

1.17. "Moskthimi"- është një parim mbi bazën e të cilit shteti obligohet gratë dhe fëmijët azilkërkues, persona me status të refugjatit ose persona nën mbrojtje subsidiare të mos i dëbojë ose t'i kthejë ato në asnjë mënyrë në kufijtë e shtetit në të cilin ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për jetën dhe trupin, nga dhuna ndaj grave ose dhuna në familje, ose liria e tyre do të rrezikohet për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose besimit politik ose kur ato do t'i nënshtroheshin torturave, trajtimeve çnjerëzore ose degraduese ose dënimit;

1.18. "Pala e mbrojtur"- personi në dobi të cilit është lëshuar urdhri i mbrojtjes;

1.19. "I/e mbijetuar"- personi i cili e ka tejkaluar dhunën në familje apo dhunën e drejtuar ndaj grave;

1.20. "Përfaqësuesi i autorizuar" -personi i cili është i autorizuar për të mbrojtur interesat

e palëve në procedurë;

1.21. “Mbrotësi i viktimave”-Përfaqësues i autorizuar për mbrojtjen e interesave të viktimës dhe realizimin e të drejtave të saj/ tij në përputhje me këtë ligj dhe ligjeve të tjera në fuqi;

1.22. “Urdhër mbrojtje”- urdhri i lëshuar me vendim gjykate apo nga policia, me të cilin parashikohen masat mbrojtëse për viktimën dhe përfshin urdhrin mbrojtës të rregullt, urdhrin mbrojtës emergjent dhe urdhrin mbrojtës të përkohshëm emergjent.

## **KAPITULLI II PARIMET THEMELORE**

### **Neni 4 Mosdiskriminimi**

1. Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore është shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe përbën diskriminim që i kufizon ato të gëzojnë të drejtat dhe liritë mbi një bazë të barabartë me burrat.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji nga palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyra, feje, mendimi politike ose mendimi tjetër, origjinën kombëtare ose sociale, përkatësi e një pakice kombëtare, pasurie, lindje orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësi të kufizuar, statusi civil, statusi i emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

3. Masat, aktivitetet dhe shërbimet e këtij ligji do të ndërmerren për të zbatuar parimin e barazisë, për të eliminuar stereotipat në lidhje me rolet gjinore, parandalimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit ndaj grave, viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje.

### **Neni 5 Trajtimi me prioritet**

1. Institucionet shtetërore, personat juridikë që kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligj, funksionarët, zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar që kryejnë punë në emër të shtetit, kanë detyrimin të trajtojnë me prioritet të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar çdo efekt të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje.

2. Subjektet nga paragrafi 1 të këtij neni janë të detyruar të ndërmarrin me prioritet të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, gjyqësore dhe masa të tjera, për të parandaluar, mbrojtur, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar kompensim të drejtë të viktimave përfshirë edhe pjesëtimin me prioritet të pasurisë së përbashkët për viktimat e dhunës në familje.

3. Personat zyrtarë në institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale, punëve të brendshme, shëndetësisë, mbrojtjen e fëmijëve dhe arsimin, si dhe gjykatat kompetente në procedurat civile, administrative dhe penale për dhunën në familje, dhunën në baza gjinore dhe dhunë ndaj grave janë të detyruar të veprojnë urgjentisht, me prioritet të shtuar ndaj interesave dhe nevojave të viktimës.

4. Trajtimi me prioritet nënkupton edhe kujdesin e shtuar në ndërmarrjen e masave të nevojshme për vlerësimin e rrezikshmërisë, nga të gjitha autoritetit relevante, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së dhunës.

## **Neni 6**

### **Ndalimi i viktimizimit**

Ndalohet çdo veprim i ndërmarrë apo joveprim që me qëllim ose pa dashje që të ndëshkohet ose të vihet në pozicion më pak të favorshëm një person i cili ka ndërmarrë veprime për t'u mbrojtur nga dhuna në familje, në bazë gjinore dhe, përkatësisht nëse personi ka raportuar dhunë, ka filluar një procedurë për mbrojtje, apo ka dëshmuar gjatë procedurës ose në mënyrë tjetër, ka marrë pjesë në procedurë për mbrojtje sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe konventave ndërkombëtare, të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik.

## **Neni 7**

### **Përshtatshmëria e veprimeve**

1. Institucionet publike të cilat bartin detyrime sipas këtij ligji për të ndërmarrë masat, aktivitetet dhe shërbimet për viktimat e dhunës në bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje duhet t'i përshtatin ato me nevojat specifike të viktimave të ndjeshme.
2. Masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalim dhe mbrojtje të grave nga dhuna e bazuar gjinore dhe nga dhuna në familje, sigurohen në mënyrë që mundëson fuqizimin e potencialit dhe kapaciteteve të viktimave për organizim të pavarur të jetës në të ardhmen.
3. Viktima dhe/ose përfaqësuesi ligjor ka të drejtë të marrë pjesë në vlerësimin e gjendjes dhe nevojave, të njoftohet për masat, aktivitetet dhe shërbimet për mbrojtje dhe të marrë pjesë në zgjedhjen e shërbimeve dhe masave për ndihmë, përkrahje dhe mbrojtje të saj.
4. Pa pajtim të viktimës, përkatësisht përfaqësuesit të saj ligjor, nuk mund të ndërmerren masat, aktivitetet dhe shërbimet për mbrojtje, përveç kur ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën e saj dhe trupin e tij/saj, duke përfshirë edhe viktimat fëmijë të dhunës në familje.

## **Neni 8**

### **Integrimi gjinor**

Institucionet publike obligohen për përfshirjen e perspektivës gjinore si kriter i cili është i integruar në të gjitha fazat nga procesi i krijimit të politikave, vlerësimi i gjendjeve, zbatimi dhe vlerësimi i politikave të cilat dalin nga ky ligj.

## **KAPITULLI III**

### **INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE JURIDIKSIONI**

## **Neni 9**

### **Kompetenca për zbatimin e ligjit**

1. Kompetente për zbatimin e këtij ligji janë të gjitha organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokuroritë, policia, qendrat për punë sociale, mbrojtësit e viktimave, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe personat juridikë të cilët kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligj.
2. Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të detyruar që të sigurojnë punët nga kompetenca e vet ta kryejnë persona profesionalë, të trajnuar për zbatimin e punëve të përcaktuara me këtë ligj.

## **Neni 10**

### **Detyrimet e përgjithshme**

1. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, institucionet e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës, obligohen të zbatojnë masat

legjislative dhe masat e tjera duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:

- 1.1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe planeve të veprimit në përputhje me këtë ligj dhe me programin kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore;
- 1.2. Vendosjen e të drejtave të viktimave në qendër gjatë hartimit të të gjitha politikave, dokumenteve dhe legjislacionit nga paragrafi 1 i këtij neni;
- 1.3. Miratimin e masave për të nxitur ndryshimet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me synimin për të zhdukur paragjykimet, zakonet, traditat dhe të gjitha praktikatat e tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet stereotipi të grave dhe meshkujve;
- 1.4. Caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte dhe iniciativa për parandalimin e dhunës në familje, dhe duke ofruar përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës ndaj grave fuqizimin dhe riintegrimin e viktimave, dhe duke siguruar që nevojat specifike të viktimave të cenueshme të merren parasysh dhe të adresohen siç duhet;
- 1.5. Bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe shoqatat profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të medias, për të forcuar kapacitetin e mediave për raportim profesional, për çështje që lidhen me dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore;
- 1.6. Të njohë, inkurajojë dhe mbështesë, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe punën e shoqërisë civile aktive në luftën kundër dhunës ndaj grave, dhe të krijojë një bashkëpunim efektiv me këto organizata;
- 1.7. Ngritjen e kapaciteteve të personave përgjegjës, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe ndaj grave, me qëllim të parandalimit dhe identifikimit të dhunës, nevojave dhe të drejtave të viktimave si dhe parandalimin e ri viktimizimit të tyre;
- 1.8. Organizimin e fushatave të vetëdijesimit për dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe barazinë gjinore, në bashkëpunim me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare në veçanti organizatat e grave, mekanizmat për të drejtat e njeriut dhe median;
- 1.9. Mbledhjen dhe raportimin e rregullt të të dhënave statistikore të ndara në baza gjinore për të gjitha format e dhunës të rregulluara me këtë ligj;
- 1.10. Në bazë të fushëveprimit të bëjnë përgatitjen dhe mbështetjen e hulumtimeve lidhur me shkaqet, efektet dhe nivelin e rasteve të dhunës dhe ndëshkimit të tyre.

#### **Neni 11**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të kompetencave të veta ndërmerr masa dhe aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje përmes përfshirjes së parimit të barazisë dhe eliminimit të stereotipave për role gjinore në nismat legjislative dhe rregullave tjera; organizimin dhe financimin e fushatave kombëtare për ngritjen e vetëdijesimit për të gjitha format e dhunës së bazuar gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje e të tjera.

## **Neni 12**

### **Strategjia Kombëtare për parandalimin mbrojtjen dhe trajtimin nga Dhuna në Familje, dhuna ndaj grave**

1. Qeveria e miraton strategjinë Kombëtare për Parandalimin Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe planin e veprimit.
2. Koordinatori Kombëtar udhëheq procesin e hartimit dhe dorëzon në Qeveri për miratim Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
3. Strategjia kombëtare përcakton detyrat dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e politikave që synojnë parandalimin, mbrojtjen, koordinimin, procedimin, risocializimin dhe riintegrimin, të gjitha institucionet kanë për obligim të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga plani i veprimit të strategjisë.
4. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe plani i veprimit bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

## **Neni 13**

### **Koordinatori/ja, kombëtar/e për mbrojtje nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore**

1. Me vendim të Kryeministrit emërohet ministri përgjegjës për drejtësi, si Koordinator/e Kombëtar/e kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.
2. Koordinatori/ja Kombëtar/e për Mbrojtje nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore është autoriteti më i lartë institucional për koordinim, bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga ky Ligj, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar janë si në vijim:
  - 3.1. Udhëheqja e procesit të hartimit dhe monitorimit të zbatimit të strategjisë kombëtare dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhuna ndaj grave;
  - 3.2. Koordinimi, bashkërendimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga ky Ligj dhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
  - 3.3. Kryesimi dhe përfaqësimi i Grupit Koordinues Ndërmënyës për mbrojtjen nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave;
  - 3.4. Është përgjegjës për të raportuar para qeverisë, parlamentit të paktën një herë në vit;
  - 3.5. Udhëheqja e procesit të ngritjes së kapaciteteve të mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, në bashkëpunim me Agjencinë për barazi gjinore.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë si dhe organizimi dhe funksionimi i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe funksionimi i grupit koordinues ndërministror rregullohet me akt nënligjor të cilin e propozon ministria përgjegjëse për drejtësi dhe e miraton Qeveria.

5. Rolin e Zëvendës koordinatorit Kombëtar e ushtron Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit.

6. Koordinator kombëtar si dhe grupi ndërmintor mbështetet nga Sekretariati që për detyrë themelore dhe përgjegjësi e ka mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet e tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave si dhe përgatitja e raporteve analitike/monitoruese për koordinatorin kombëtar dhe veprimeve tjera sipas kërkesës së Koordinatorit/es Kombëtar.

7. Sekretariati mbështetës nga paragrafi 6 i këtij neni themelohet dhe funksionon në kuadër të ministrisë përgjegjëse për fushën e drejtësisë.

#### **Neni 14**

##### **Roli i Agjencisë për Barazi Gjinore**

1. Agjencia për Barazi Gjinore në përputhje me fushëveprimtarinë e saj siguron përfshirjen e perspektives gjinore në të gjitha politikat publike dhe legjislacionin, sistemet dhe proceset si:

1.1. Në koordinim me ministrinë përgjegjëse për drejtësi udhëheqin procesin e rishikimit, plotësimit dhe vlerësimit të zbatimit të Procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën në bazë gjinore;

1.2. Në koordinim me ministrinë përgjegjëse të drejtësisë, koordinojnë procesin e ngritjes së kapaciteteve institucionale e ndërsektoriale për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe në përputhje me Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, dhuna ndaj grave dhe në bazë gjinore;

1.3. Në koordinim me ministritë përgjegjëse, koordinojnë procesin e ngritjes së kapaciteteve të mediave për eliminimin e stereotipave gjinore dhe gjuhës seksiste në programe dhe produkte mediatike.

2. Sipas kërkesës nga Koordinator/ja Kombëtare kundër dhunës dhe me miratim të Grupit Koordinues Ndërmintor kundër dhunës, Agjencia për Barazi Gjinore ndërmerr edhe aktivitete tjera në fushën e përgjegjësisë të Koordinatorës Kombëtare.

#### **Neni 15**

##### **Grupi koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje**

1. Koordinator/ja Kombëtare kundër dhunës udhëheq Grupin Koordinues ndërmintor kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në bazë gjinore me këtë përbërje:

1.1. Zyra e Kryeministrit - Agjencia për Barazi Gjinore, zëvendëskryesues;

1.2. Ministria përgjegjëse për punët e brendshme, anëtar;

1.3. Ministria përgjegjëse për financa punë dhe transfere, anëtar;

1.4. Ministria përgjegjëse për Drejtësi, anëtar;

1.5. Ministria përgjegjëse për shëndetësi, anëtar;

1.6. Ministria përgjegjëse për arsim, anëtar;

1.7. Ministria përgjegjëse për pushtetin lokal, anëtar; dhe

1.8. Ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport, anëtar;



- 1.9. Policia e Kosovës, anëtar;
- 1.10. Prokuroria e Shtetit, anëtar;
- 1.11. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;
- 1.12. Akademia e Drejtësisë, anëtar;
- 1.13. Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës, anëtar;
- 1.14. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, anëtar, dhe
- 1.15. Përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, anëtar.

2. Anëtarë të përhershëm si përfaqësues të ministrive janë zëvendësministrat përgjegjës. Në rast pamundësie, mund të delegojnë anëtarësinë në një zyrtar të kabinetit përgjegjës.

3. Me ftesën e Kryesuesit / Koordinatorës/it Kombëtar/e, mund të ftohen edhe përfaqësues të ministrive të tjera dhe institucioneve të tjera relevante, varësisht nga detyrimet që dalin nga strategjia për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve strategjikë në cilësinë e vëzhguesve.

4. Grupi Koordinues ndërministror ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

4.1. Zbatimin, rishikimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të strategjisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit;

4.2. Koordinatori Kombëtar dhe Grupi i Koordinimit Ndërministror shërben si organ koordinues përgjegjës për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga ky Ligj dhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

4.3. Koordinimin e të gjitha aktiviteteve brenda vendit me qëllim sigurimi dhe bashkëpunimi ndërinstucionalë dhe ndërsektorialë, duke përfshirë grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave, sigurimin e buxhetit, resurseve humane për zbatimin e strategjisë.

5. Detyrohen të gjitha institucionet e të gjitha niveleve që të përgjigjen ndaj të gjitha kërkesave të Grupit koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje.

### **Neni 16** **Përgjegjësitë e Mbrojtësive të Viktimave**

1. Detyrat edhe përgjegjësitë e Mbrojtësive të viktimave sipas këtij Ligji përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1. Takimin e viktimës menjëherë pas referimit të rastit të dhunës në familje në polici;
- 1.2. Informimin e viktimës rreth të drejtave të tij apo saj, ndihmën që është në dispozicion dhe procedurat e urdhrave mbrojtës;
- 1.3. Përpilimin e kërkesës për urdhërmbrojtje me pëlqimin e viktimës dhe në mbledhjen e dokumentacionit/provave të nevojshme për mbështetjen e kërkesës;
- 1.4. Paraqitjen e kërkesës për urdhërmbrojtje në gjykatë pas marrjes së pëlqimit nga viktimia apo përfaqësuesi ligjor i tij apo saj;

1.5. E përfaqëson viktimën në gjykatë në të gjitha seancat për kërkesën për urdhërmbrojtje dhe e ndihmon në përpilimin e parashtrësve dhe mjeteve tjera juridike.

2. Çdo ndihmë dhe veprim lidhur me procedurën e kërkimit të urdhrave mbrojtës e bën në bazë të pëlqimit të viktimës.

3. Përveç obligimeve në përfaqësimin e viktimës në procedurën e kërkimit të urdhrave mbrojtës, mbrojtësi i viktimave po ashtu e informon viktimën për të drejtën e saj për kompensim nga shteti, e udhëzon dhe ndihmon viktimën në parashtrimin e kërkesës për kompensim në përputhje me Ligjin për Kompensimin e viktimave.

### **Neni 17**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore**

1. Ministria përkatëse për Arsim, përveç masave të përgjithshme parandaluese të përcaktuara në nenin 10. të këtij Ligji, në përputhje me fushëveprimtarinë e saj, ndërmerr edhe masat e posaçme parandaluese si në vijim:

1.1. Përfshin në kurrikulën e niveleve parauniversitare të arsimit, tema që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, njohuri mbi identitetin gjinor, të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual;

1.2. Organizon për stafin arsimor trajnime të vazhdueshme themelore dhe profesionale mbi barazinë gjinore, respekti reciprok, e drejta për integritet personal, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, dhe sigurimin e njohurive mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual.

2. Institucionet e arsimit të lartë përfshijnë në kurrikulën e tyre çështje që trajtojnë barazinë gjinore, identitetin gjinor, respektimin e diversitetit, dhunën në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore.

### **Neni 18**

#### **Programet për parandalimin e përsëritjes së dhunës**

1. Detyrohen ministritë përkatëse për drejtësi, arsim dhe shëndetësi, të krijojnë programe të veçanta psikosociale të trajtimit, me qëllim të ndryshimit të sjelljeve të dhunshme dhe programe të veçanta të trajtimit për kryerësit e dhunës seksuale.

2. Programet nga paragrafi 1 i këtij neni kanë për qëllim kryesor parandalimin e përsëritjes së dhunës.

### **Neni 19**

#### **Përgjegjësitë e Policisë së Kosovës**

1. Policia e Kosovës duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore ose shkëljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.

2. Policia vlerëson rrezikshmërinë për rastin e raportuar që nga momenti i reagimit fillestar dhe merr masat e sigurisë për viktimën, anëtarët që janë në marrëdhënie familjare me të dhe personat e tjerë të përfshirë në rast.

3. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin.

4. Policia e Kosovës ndërmerr masa të përshtatshme për të parandaluar dhunën dhe për të mbrojtur viktimat duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:

4.1. Sigurimin e linjës së posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje dhe dhunën ndaj grave dhe regjistrimin e këtyre thirrjeve;

4.2. Informimin e viktimës, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e viktimës në përputhje me këtë ligj, në veçanti të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente sipas nenit 28. 52. 53. dhe 54. të këtij ligji;

4.3. Informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera të ofruara nga institucionet qeveritare dhe rrejtit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;

4.4. Informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përcaktuara sipas këtij ligji, dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkesën e viktimës;

4.5. Sigurimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor gjatë procedimit të rastit në polici;

4.6. Sigurimin e transportimit të viktimës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj deri në një vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës dhe së bashku me punëtorin social;

4.7. Nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që e ka lajmëruar dhunën, në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;

4.8. Largimin e palës përgjegjëse nga banesa ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur apo ndonjë pjesë të saj në rastin kur me anë të urdhrin për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 32 të këtij ligji;

4.9. Sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimën ose përfaqësuesin e saj ligjor me policin hetues të dhunës në familje në kuadër të Policisë së Kosovës. Nëse mungon polici hetues i dhunës në familje, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i Policisë së Kosovës duhet t'i ndihmojë viktimës.

5. Policia e Kosovës e përpilon raportin ditor lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra dhe a është ndaluar dikush dhe një kopje të këtij raporti ia dorëzon viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor, mbrojtësit të viktimës dhe Qendrës për Punë Sociale.

6. Policia e Kosovës në momentin e identifikimit të viktimës së dhunës në familje ose dhunës ndaj grave duhet të ftojë për t'ju përgjigjur rastit menjëherë prokurorin e shtetit, në rast se veprimet përbëjnë vepër penale sipas përkufizimeve të Kodit Penal, Qendrën për Punë Sociale ku ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin dhe mbrojtësin e viktimave, me qëllim të vlerësimit të rrezikshmërisë, nevojave të viktimës dhe njoftimit me të drejtat e viktimës.

7. Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi ose është gjetur vendndodhja e tij, Policia e Kosovës duhet ta njoftojë rregullisht viktimën apo përfaqësuesin ligjor dhe mbrojtësin e viktimës për procesin e hetimeve, duke përfshirë informata lidhur me vendndodhjen e të dyshuarit për dhunë ose lirimin e tij apo të saj nga burgimi.

8. Policia e Kosovës zbaton të gjitha urdhrat dhe detyrat e caktuara nga gjykata.

9. Ministri i Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë vendosin strukturën organizative dhe hierarkinë e organeve në kuadër të policisë për trajtimin e dhunës në familje

dhe dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore me kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

10. Policia e Kosovës obligohet t'i funksionalizojë dhomat mike me qëllim të trajtimit të veçantë të viktimave dhe vartësve të tyre.

#### **Neni 20**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë përkatëse për mirëqenie sociale**

1. Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, përveç masave të përgjithshme parandaluese të përcaktuara në nenin 10. të këtij Ligji, në përputhje me fushëveprimtarinë e saj, ndërmer masat e posaçme parandaluese si në vijim:

1.1. Siguron shërbime profesionale, dhe këshilluese lidhur me trajtimin e dukurisë së dhunës;

1.2. Siguron hartimin dhe monitorimin e zbatimit të standardeve për shërbime sociale në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, i cili nënshkruhet nga ministri;

1.3. Prezanton një program për riorganizimin e të drejtave të punësimit të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në vendin e punës në sektorin publik dhe privat.

2. Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Financave, harton dhe prezanton program për riaftësim dhe punësim për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në sektorin publik dhe privat. Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Financave janë përgjegjëse për nxjerrjen e aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni.

3. Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për ambient dhe planifikimit hapësinor dhe ministrinë përkatëse për pushtetin lokal, harton dhe prezanton programin për banim social të viktimave të dhunës në familje.

#### **Neni 21**

#### **Përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale (QPS), sipas këtij Ligji përfshijnë:

1.1. Intervenimin në secilin rast kur kontaktohet nga policia e Kosovës;

1.2. Intervenimin sipas detyrës zyrtare, në secilin rast kur dyshohet se ka dhunë në familje dhe intervenimin në raste kur kontaktohen nga aktorët në sistemin referues për mbrojtje nga dhuna në familje;

1.3. Çdo viktime të identifikuar dhe referuar i caktohet një menaxher i rastit, i/e cili/a është profesionist/e në kuadër të QPS-së për të udhëhequr procesin e mbrojtjes sociale të viktimës në identifikimin, koordinimin dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve sociale ekzistuese;

1.4. Kontaktimin e viktimës së rritur dhe fëmijë menjëherë pas identifikimit dhe referimit të rastit të dhunës në familje;

1.5. Caktimin nga udhëheqësi i shërbimeve sociale, të kujdestarit ligjor i cili përfaqëson interesin më të lartë të fëmijës në rastet kur fëmijët janë viktimat e dhunës në familje nga ana e prindërve biologjik ose kujdestarit/es;

1.6. Ndërmarrjen e masave urgjente për mbrojtjen e dinjitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës, nga QPS-ja kur mësohet për rrezikun ekzistues për fëmijën për shkak të abuzimit të të drejtës prindërore ose çfarëdo rreziku për fëmijën nga neglizhenca serioze e detyrave prindërore;

1.7. Kur Organi i Kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilin do vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon 72 orë;

1.8. Menaxheri i rastit, pas vlerësimit të situatës në kuadër të mbrojtjes sociale dhe integritetit, mbështet dhe referon të mbijetuarën në program të riaftësisimit dhe punësimit, për fuqizim dhe jetë të pavarur;

1.9. Para se të skadojë afati prej 72 orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë 21 ditësh, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime, deri në të cilën kohë çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm. Me vendosjen e fëmijës nën mbrojtjen e Organit të Kujdestarisë nuk pushojnë të drejtat e tjera që u takojnë prindërve, as detyrat e tyre ndaj fëmijës;

1.10. Në koordinim me institucionet tjera dhe në bazë të vlerësimit të nevojave të viktimës apo rrezikshmërisë personale të viktimës, siguron strehim të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje;

1.11. QPS-ja në bazë të kërkesës nga organet e drejtësisë kompetente obligohet ta përgatisë anamnezën sociale për secilin rast;

1.12. Në çdo rast të dhunës në familje është e obliguar të referojë ose të ofrojë këshillim psikosocial për viktimën e dhunës në familje apo ndaj grave dhe personat në varësi të saj/tij;

1.13. QPS-ja në koordinim me institucionet tjera siguron strehim të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje dhe ndaj grave dhe personat në varësi të saj;

1.14. Menaxheri i rastit në procesin e mbështetjes së viktimës koordinon aktivitetet për riintegrim;

1.15. QPS-ja obligohet të përcjell rastin e viktimës deri në përmbylljen e rastit nga aspekti i mbrojtjes sociale;

1.16. Me kërkesën e palës së mbrojtur ose sipas detyrës zyrtare kur pala e mbrojtur është fëmijë, përpilon dhe parashtron kërkesën për urdhërmbrojtje dhe merr pjesë në procedurat gjyqësore sipas këtij Ligji;

1.17. QPS-ja duhet ta zbatojë vendimin e gjykatës lidhur me përmbylljen e obligimeve që dalin nga vendimi dhe në rast të mospërmbylljes së obligimeve duhet ta informojë gjykatën përmes një raporti për arsyet e mospërmbylljes;

1.18. Menaxheri i rastit pas vlerësimit të situatës referon rastin në shërbimin e skemës së ndihmës sociale për të gjitha rastet të cilat nuk kanë asnjë të hyrë apo nuk kanë pengesa në bazë të legjislacionit në fuqi për skemat sociale.

2. Qendrat për punë sociale duhet të krijojnë një fond emergjent për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ata/ato janë në polici. Procedurat për këtë çështje rregullohen me akt nënligjor të

nxjerrë nga Ministria përkatëse për Drejtësi.

## **Neni 22**

### **Shërbimet mbështetëse për viktimat**

1. Për qëllim të parandalimit dhe lehtësimit të pasojave të dhunës në familje dhe zbatimit efektiv të masave mbrojtëse për viktimën në kuadër të këtij ligji, institucionet e Republikës së Kosovës varësisht nga fusha e përgjegjësisë administrative, ofrojnë shërbimet mbështetëse si vijim:

- 1.1. Informimi i viktimës për të drejtat e saj dhe shërbimet ekzistuese në komunitet;
- 1.2. Strehimin e përkohshëm të viktimës së dhunës në familje dhe personave të tjerë, në rastet kur duhet të largohet nga hapësira e banimit, ku ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës;
- 1.3. Ofrimin e kujdesit emergjent shëndetësor, dhe shërbimeve tjera shëndetësore sipas nevojës;
- 1.4. Ndihmën juridike falas dhe përfaqësimin ligjor falas në gjykatë gjatë procedurave të kërkesës për urdhërmbrojtje dhe procedurave tjera civile ose penale;
- 1.5. Referimin e viktimës në programin e kompensimit dhe asistimin për parashtrimin e kërkesës për kompensim;
- 1.6. Ofrimin e trajtimit psikosocial dhe programeve tjera rehabilitimi, sipas nevojës së viktimës;
- 1.7. Ofrimin e programeve të këshillimit, orientimit dhe aftësisimit profesional ose sigurimin e viktimave të dhunës në familje të marrin pjesë në trajnimet e aftësisimit profesional nga qendrat rajonale për aftësim profesional dhe zyrat e punësimit dhe palët e treta;
- 1.8. Ofrimin e programeve për mundësi punësimi dhe programe tjera të riintegritimit;
- 1.9. Ofrimin e programeve edukative dhe mundësi për të vijuar arsimimin për viktimën dhe fëmijët e saj;
- 1.10. Ofrimin e mbështetjes financiare përmes shërbimeve ekzistuese të asistencës sociale, nëse rastet kur plotësohen kushtet sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.11. Ofrimin e strehimit të përhershëm për viktimat e dhunës në Familje përmes banimit social apo mbështetjes financiare për mundësimin e strehimit;
- 1.12. Shërbimet mbështetëse sigurohen dhe ofrohen dhe nga organizatat e licencuara në përputhje me këtë Ligj;
- 1.13. Shërbimet mbështetëse për viktimat ofrohen falas dhe pa diskriminim dhe financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- 1.14. Të gjithë punonjësve të shërbimeve të mbështetjes së viktimave do t'u kërkohej t'i nënshtroheshin trajnimit të vazhdueshëm të detyrueshëm me ndjeshmëri gjinore në përputhje me udhëzimet dhe kurrikulën që fokusohet në parandalimin dhe zbulimin e dhunës, barazinë midis grave dhe burrave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si parandalimi i viktimizimit dytësor dhe bashkëpunimi i koordinuar i shumë agjencive për të siguruar trajtimin e plotë dhe të duhur të referimeve.

**Neni 23****Linja telefonike emergjente**

1. Linja telefonike emergjente siguron në çdo kohë e ditë informacion të saktë në kohë, konfidencial për mbrojtjen e viktimave, shërbimet në dispozicion të viktimave dhe këshillim telefonik për viktimat e dhunës në familje, dhunës në baza gjinore dhe dhunës ndaj gruas.
2. Linja telefonike emergjente sipas paragrafit 1 të këtij neni, siguron informatat në të gjitha gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, për sa i përket mbrojtjes së viktimave, shërbimeve në dispozicion të viktimave, referimit dhe këshillimit në telefon për viktimat e Dhunës në familje, Dhunës ndaj grave dhe Dhunës në baza Gjinore.
3. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme janë përgjegjëse për hartimin e një akti nënligjor, i cili miratohet nga qeveria për zbatim të këtij neni.

**Neni 24****Strehimoret e specializuara për strehimin e viktimave të dhunës**

1. Ofruesit e shërbimeve sociale të specializuar në kuadër të mbrojtjes, strehimit, rehabilitimit dhe riintegrit, mund të jenë nga sektori publik dhe joqeveritar.
2. Ofruesit e shërbimeve që zhvillojnë aktivitete për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore duhet t'u përmbahen standardeve minimale, rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me aktivitetet e tyre siç përcaktohen nga institucioni përkatës.
3. Ofruesit nga sektori publik janë të obliguar të marrin autorizimin/pëlqim nga ministria përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë dhe mund të organizohen apo funksionojnë në bazë të modelit të qendrave të mbrojtjes me karakter të përkohshëm të strehimit dhe qendrave ditore për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës.
4. Ofruesit nga sektori joqeveritar janë të obliguar të marrin licencë nga ministria përkatëse, për ushtrimin e veprimtarisë dhe mund të organizohen apo funksionojnë në bazë të modelit të qendrave të mbrojtjes me karakter të përkohshme të strehimit dhe qendrave ditore për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës.
5. Financimi dhe mbështetja buxhetore e ofrueseve publikë dhe joqeveritarë do të bëhet mbi bazën të kostos për njësi/klient, kosto të standardeve minimale dhe kosto të shpenzimeve operative për funksionimin e një qendre për mbrojtjen e viktimave të dhunës.
6. Institucionet nga niveli qendror dhe lokal, varësisht nga fusha përgjegjëse mund të kontraktojnë shërbime sociale nga ana e sektorit joqeveritar të licencuar për mbrojtjen, strehimin, rehabilitim dhe ri-integrimin e viktimave të dhunës në familje.
7. Institucionet nga niveli qendror dhe lokal, varësisht nga përgjegjësitë për fushën përgjegjëse dhe objektivat nacionale, mund të financojnë projektet e sektorit joqeveritar për mbrojtjen, strehimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës.
8. Financimi i strehimoreve dhe qendrave të licencuara, bëhet përmes alokimit të fondeve nga Buxheti i Kosovës, pa përjashtuar mbështetjen me grante apo subvencione, me qëllim të zbatimit të programeve afatmesme dhe masave prioritare, për ofrimin e shërbimeve të viktimave të dhunës në familje. Për këtë Qeveria e Kosovës dedikon mjete adekuate buxhetore për financimin e qëndrueshëm të strehimoreve të licencuara për periudhe kohore, jo më pak se tri vjet, dhe krijon një linjë buxhetore apo nënprogram buxhetor, me kod të veçantë në kuadër të ministrisë përgjegjëse.
9. Procedurat e shpërndarjes, monitorimit, licencimit dhe financimit të këtyre shërbimeve

rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga Ministria përkatëse për mirëqenie sociale në bashkëpunim me Agjencinë për Barazinë Gjinore dhe të nxjerrë nga Qeveria.

10. Organizimi i strehimoreve duhet të bëhet në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, 1/10 000 persona.

11. Qeveria siguron financim të qëndrueshëm për strehimoret.

### **Neni 25**

#### **Mekanizmat Koordinues lokalë për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore**

1. Të gjitha komunat janë të obliguara të krijojnë mekanizma koordinues lokalë për mbrojtje nga dhuna në familje dhe ndajnë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të koordinuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, në nivel lokal.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e mekanizmit lokal për mbrojtje nga dhuna në familje e përfshijnë por nuk kufizohen në:

2.1. Koordinimin ndërinstitucionalë të pushtetit lokal për zbatimin të këtij ligji dhe detyrave e përgjegjësisë që dalin nga ky ligj dhe Strategjia Kombëtare për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe dhuna dhe plani i veprimit;

2.2. Raportimin ndaj Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për mbrojtje nga dhuna në familje dhuna ndaj grave për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë;

2.3. Mekanizmat koordinues lokalë duhet të hartojnë plane të veprimit me qëllim të zbatimit të strategjisë kombëtare.

3. Agjencia për barazi gjinore e udhëheqë procesin e ngritjes së kapaciteteve të mekanizmave koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave.

4. Koordinatori Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i mbështetur nga grupi ndërministror koordinues monitoron në mënyrë të rregullt punën e mekanizmave koordinues lokalë.

5. Mekanizmi lokal Koordinues i kryen detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë ligj dhe në pajtim me aktin nënligjor të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe të miratuar nga Qeveria.

### **Neni 26**

#### **Mediat dhe institucionet monitoruese të tyre**

1. Me qëllim të parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, dhe dhunës në baza gjinore operatorët që ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale në Republikën e Kosovës, obligohen që:

1.1. Të krijojnë dhe zbatojnë programe informative dhe edukative për ngritjen e vetëdijes tek publiku i gjerë në media për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore;

1.2. Promovojnë barazinë gjinore, eliminimin e stereotipave gjinore dhe eliminimin e gjuhës seksiste në programet dhe produktet mediatike;

1.3. Obligohet Komisioni i Pavarur i Mediave për monitorimin e përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.



## KAPITULLI IV MASAT MBROJTËSE DHE PROCEDURA E SHQIPTIMIT TË TYRE

### Neni 27 Juridiksioni i Gjykatës

1. Gjykata themelore në procedurën kontestimore, me juridiksionin në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin, është kompetente për shqiptimin e masave mbrojtëse.
2. Çdo Gjykatë themelore është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje të rregullt ose urdhërmbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhrin, nëse gjykata kompetente sipas paragrafit 1 të këtij neni e ka paraqitur kërkesën për urdhërmbrojtje të rregullt ose urdhërmbrojtje emergjente në atë gjykatë dhe nëse ajo gjykatë ka juridiksion në komunën në të cilën pala e mbrojtur e ka ndërruar vendbanimin apo vendqëndrimin, apo nëse kjo bartje i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur.
3. Nëse në gjykatën kompetente është parashtruar kërkesa, e njëjta gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje të rregullt ose urdhërmbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhrin.
4. Gjykata themelore kompetente, mund të shqiptojë me urdhërmbrojtje të rregullt apo me urdhërmbrojtje emergjente, një apo më tepër masa mbrojtëse.
5. Gjykata i shqyrton me prioritet rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.
6. Gjykata nuk mund të refuzoj shqiptimin e urdhrit mbrojtës të rregullt për shkak të ndonjë procesi tjetër gjyqësor ku janë të përfshira palët.

### Neni 28 Urdhrat dhe masat mbrojtëse

1. Urdhrat e mbrojtjes janë masa të shqiptuara nga Gjykata, respektivisht Policia, të cilët kanë për qëllim parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe sigurinë e viktimës dhe personave të tjerë të ekspozuar ndaj dhunës, evitimin e pasojave dhe mënjanimin e rrethanave që ndikojnë apo mund të ndikojnë në përsëritjen e dhunës. Urdhrat për mbrojtje shqiptohen edhe për personat që nuk janë në marrëdhënie familjare, si dhe për mbrojtje të viktimave të dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual dhe të kategorive të tjera të mbrojtura nga ky ligj.
2. Urdhrat për mbrojtje të rregullt mund të përmbajnë një apo më shumë masa mbrojtëse dhe mund të jenë:
  - 2.1. Urdhri mbrojtës i rregullt është urdhri i shqiptuar nga Gjykata në procedurë të rregullt. Kohëzgjatja e Urdhrit mbrojtës të rregullt është deri në 12 muaj, me mundësi vazhdimi, e që nuk mund të jetë më gjatë se 24 muaj. Kufizimi sipas këtij paragrafi nuk e ndalon parashtruesin të paraqesë kërkesë të re;
  - 2.2. Ky urdhër vlen deri në skadimin, ndërprerjen, apo nxjerrjen e një urdhri të ri mbrojtës nga ana e gjykatës;
  - 2.3. Urdhri mbrojtës emergjent është urdhër i lëshuar nga Gjykata në procedurë të përshpejtuar për të ofruar mbrojtje të menjëhershme për palën e mbrojtur;
  - 2.4. Urdhri mbrojtës i përkohshëm emergjent është urdhri i lëshuar nga ana e Policisë jashtë orarit të punës së Gjykatës. Ky urdhër vlen deri në ditën e parë të punës së

Gjykatës.

3. Masat mbrojtëse zbatohen për të gjitha format e dhunës të parapara me këtë ligj, nëse të njëjtat konsiderohen adekuate për të arritur qëllimin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

#### **Neni 29**

##### **Masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të dhunës**

Masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të dhunës obligon palën përgjegjëse të ndërpresë dhe të mos përsërisë asnjë veprim të dhunshëm ndaj palës së mbrojtur, personave në marrëdhënie familjare me të, kafshëve shtëpiake apo të mos e dëmtojë pasurinë.

#### **Neni 30**

##### **Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të palës së mbrojtur**

Masa e ndalimit të shqetësimit mund të shqiptohet për të ndaluar palën përgjegjëse që në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave të tretë apo çfarëdo lloj mënyre tjetër të komunikimit të ngacmojë, shqetësojë, manipulojë, ofendojë, kërcënojë, përndjekë apo vëzhgojë palën e mbrojtur dhe personat në marrëdhënie familjare me atë.

#### **Neni 31**

##### **Masa mbrojtëse e kufizimit të afrimit palës së mbrojtur**

1. Masa mbrojtëse e kufizimit për t'iu afruar palës së mbrojtur, personave në marrëdhënie familjare me të dhe vendeve që ata frekuentojnë, mund t'i shqiptohet palës përgjegjëse nëse ekziston rreziku i përsëritjes së sjelljes së dhunshme apo me qëllim të parandalimit të formave tjera të dhunës.

2. Në urdhrin me të cilin shqiptohet masa e kufizimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Gjykata i cakton palës përgjegjëse vendin, regjionin dhe largësinë, brenda së cilës i njëjti nuk guxon ti afrohet palës së mbrojtur dhe personave në marrëdhënie familjare me të.

3. Gjykata cakton monitorimin elektronik të kësaj mase, të cilën e zbaton policia sipas ligjit në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës.

#### **Neni 32**

##### **Masa mbrojtëse e largimit të palës përgjegjëse nga hapësira e banimit**

1. Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet palës përgjegjëse që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton.

2. Palës përgjegjëse të cilit i është shqiptuar masa nga paragrafi 1 i këtij neni, obligohet ta lëshojë menjëherë banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të banimit, sipas nevojës nën shoqërimin e zyrtarit policor.

3. Palës përgjegjëse që i është shqiptuar kjo masë nuk i lejohet të hyj në hapësirën e banimit pa lejen e gjykatës përderisa masa është në fuqi.

4. Palës përgjegjëse me vendim të gjykatës mund t'i lejohet marrja e gjësendeve të domosdoshme personale nën shoqërimin e zyrtarit policor.

#### **Neni 33**

##### **Masa mbrojtëse e shoqërimit të palës së mbrojtur**

1. Masa mbrojtëse e shoqërimit të palës së mbrojtur, mund të shqiptohet me qëllim të mbrojtjes

gjatë marrjes së gjësendeve personale, kur pala e mbrojtur kërkon të largohet nga hapësira e banimit.

2. Masa nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet në shoqërimin e zyrtarit policor dhe sipas vlerësimit të gjykatës edhe punëtori social.

### **Neni 34**

#### **Masa mbrojtëse e caktimit të përkohshëm të kujdestarisë**

1. Në rastet e dhunës në familje kur çifti ka fëmijë të përbashkët, kujdestaria e fëmijës i besohet përkohësisht palës së mbrojtur, nën kushtin e vlerësimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës.

2. Në të gjitha rastet kur pala përgjegjëse ka ushtruar dhunë ndaj fëmijës, e njëjta privohet përkohësisht nga e drejta prindërore dhe kontakti me fëmijët.

3. Palës përgjegjëse që privohet përkohësisht nga kujdesi prindëror, përjashtimisht mund t'i lejohet kontakti me fëmijët, vetëm në rastet kur:

3.1. Është në interesin më të mirë të fëmijëve për të ruajtur raportet familjare dhe nuk ka asnjë rrezik që pala përgjegjëse do të ushtrorë dhunë apo do të abuzojë me viktimën apo fëmijët;

3.2. Nëse nuk ka kundërshtim nga ana e fëmijës, në rastet kur sipas ligjeve në fuqi kërkohet marrja e pëlqimit të fëmijës.

4. Nëse për shkaqe të arsyeshme, kujdestaria nuk mund ti caktohet palës së mbrojtur, Gjykata me urdhër rregullon kontaktin e palës së mbrojtur me fëmijë.

5. Palët urdhërohen që të mos largojnë fëmijën jashtë vendit pa pëlqimin dhe lejen paraprake të Gjykatës dhe mendimit të kujdestarisë.

### **Neni 35**

#### **Caktimi i mbajtjes financiare për palën e mbrojtur**

1. Gjykata urdhëron palën përgjegjëse të paguajë ushqimin për palën e mbrojtur dhe fëmijët të cilën pala përgjegjëse ka obligim për të mbajtur, në pajtim me ligjin për familjen.

2. Pala përgjegjëse urdhërohet për të paguar qiranë e banesës në shfrytëzim të palës së mbrojtur dhe fëmijës si dhe pagesat tjera të arsyeshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës, në pajtim me ligjin për familjen.

3. Vlerësimin e lartësisë së mbajtjes sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, Gjykata e bën bazuar në lartësinë e arsyeshme, duke pasur parasysh nevojat e palës së mbrojtur, të ardhurat e palëve, pagesat tjera me të cilat palët mund të jenë të ngarkuar dhe numrin e fëmijëve të përbashkët.

4. Vendimi me të cilin caktohen masat pasurore nga ky nen merr titullin Ekzekutiv ditën që vendoset.

### **Neni 36**

#### **Masa mbrojtëse të trajtimit psikosocial**

1. Gjykata sipas detyrës zyrtare mund t'i caktojë palës përgjegjëse masën mbrojtëse të trajtimit psikosocial, në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të tij/saj veçanërisht në rastet kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës.

2. Masa nga paragrafi 1. i këtij neni, zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, dhe me propozimin e ekspertit, por jo më shumë se kohëzgjatja e urdhrimit mbrojtës.
3. Institucioni apo organi i specializuar ku është referuar pala përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase e ka për obligim t'i raportojë gjykatës për zbatimin e masës dhe rezultatet e trajtimit.
4. Ministria përgjegjëse për Shëndetësi në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Mirëqenie Sociale dhe institucionet përkatëse përgatisin dhe propozojnë për aprovim në Qeveri aktin nënligjor me të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial.
5. Ministria përkatëse për shëndetësi themelon mekanizmat e nevojshëm institucionalë për trajtimin psikosocial të kryerësve të dhunës, në përputhje me këtë nen.
6. Procedurat për certifikim dhe licencim të institucioneve dhe profesionistëve që zbatojnë këto masa, mënyrën e kompensimit si dhe detyrat e përgjegjësitë e tyre, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria përkatëse për shëndetësi.

### **Neni 37**

#### **Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor të palës përgjegjëse nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope**

1. Gjykata sipas detyrës zyrtare mund të caktojë masën mbrojtëse dhe trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope, personit, i cili ka kryer dhunë nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës.
2. Institucioni apo organi i specializuar ku është referuar pala përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase e ka për obligim, t'i raportojë gjykatës për zbatimin e masës dhe rezultatet e trajtimit.
3. Ministria përgjegjëse për Shëndetësi nxjerrë akt nënligjor, për mënyrën e trajtimit të personave ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope, harton programe për trajtim, siguron hapësirat dhe personelin profesional për zbatimin e kësaj mase.

### **Neni 38**

#### **Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në institucionin e kujdesit shëndetësor**

1. Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik palës përgjegjëse që ka ushtruar dhunë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës.
2. Caktimi i kësaj mase bëhet përshtatshëm me procedurën për masat për trajtimin e detyrueshëm sipas ligjit për shëndetin mendorë të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Ministria përkatëse për Shëndetësi për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe fuqizimin e mekanizmave ekzistues për trajtimin e detyrueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Neni 39**

#### **Masa mbrojtëse e marrjes së mjetit me të cilin është kryer vepra**

1. Masa mbrojtëse e marrjes së mjetit me të cilin është kryer vepra, apo mjeteve me të cilat dyshohet se mund të ushtrohet ose përsëritet dhuna, shqiptohet me qëllim të mbrojtjes së palës së mbrojtur ndaj të cilit është ushtruar dhuna apo e personave tjerë.
2. Masa nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur pala përgjegjëse është i pajisur apo pritet të pajiset me leje për armë, mund të përfshijë edhe ndalimin që palës përgjegjëse ti lëshohet

vërtetimi për leje për armë apo t'i revokohet leja dhe sekuestrohet arma sipas dispozitave të ligjit për armët.

3. Gjykata sipas detyrës zyrtare kërkon nga pala e mbrojtur dhe apo nga pala përgjegjëse t'i bëjë të ditur nëse pala përgjegjëse posedon apo ka qasje në armë për të përcaktuar nëse pala përgjegjëse paraqet rrezik për sigurinë personale të palës së mbrojtur apo personave tjerë të mbrojtur.

4. Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, në rastet kur pala përgjegjëse është në posedim të armëve në mënyrë ilegale.

#### **Neni 40** **Masat e tjera pasurore**

1. Gjykata, krahas masave të parapara nga neni 27. deri në nenin 39. të këtij ligji, mund të shqiptojë edhe masat si në vijim:

1.1. Ndalimi i palës përgjegjëse, të bartë, vë në barrë si dhe të realizojë çdo lloj transaksioni të pasurisë së caktuar apo çfarëdo pasurie pronë e tij apo pronë e përbashkët me palën e mbrojtur, brenda një periudhe të caktuar kohore, por jo më gjatë se kohëzgjatja e urdhrit mbrojtës;

1.2. Të i lejohej palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e veçantë personale të saj.

#### **Neni 41** **Masat tjera mbrojtëse**

1. Gjykata mund të shqiptojë ndonjë masë tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personave në marrëdhënie familjare me të. Masat e tilla përfshijnë por nuk kufizohen në:

1.1. Urdhërimin e palës përgjegjëse të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj;

1.2. Urdhërimin e palës përgjegjëse të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e kanë në posedim të përbashkët apo të veçantë, gjithnjë përderisa pala përgjegjëse të mos banojë në të njëjtën banesë me palën e mbrojtur;

1.3. Urdhërimin e palës përgjegjëse që palës së mbrojtur t'i lejojë kthimin në shtëpi.

#### **Neni 42** **Ndërlidhja me urdhrat dhe procedurat tjera**

1. Urdhrat e lëshuar sipas këtij Ligji, kanë përparësi në zbatim, ndaj vendimeve të ndonjë organi tjetër në procedurë civile apo administrative.

2. Masat pasurore të shqiptuara sipas këtij Ligji aplikohen pavarësisht të drejtave të pronësisë apo posedimit të palës përgjegjëse.

3. Me skadimin e urdhrit mbrojtës pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

4. Shqiptimi i Urdhrit sipas këtij Ligji:

4.1. Nuk ndalon palët të iniciojnë procedurën penale për sa i përket veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë vepër penale;

4.2. Nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhrit;

4.3. Nuk kufizohet me kushtin që parashtruesi i kërkesës të iniciojë paraprakisht proces penal apo civil ndaj palës përgjegjëse.

5. Urdhrat për mbrojtje sipas këtij Ligji mund të shqiptohen:

5.1. Si masë shtesë sigurie krahas zhvillimit të procedurës civile, administrative dhe penale ndaj palës përgjegjëse;

5.2. Si masë e vetme e sigurisë ndaj palës përgjegjëse për veprimet ndaj palës së mbrojtur, të cilat nuk paraqesin elementet e veprës penale.

#### **Neni 43**

#### **Parashtruesit e kërkesës për urdhërmbrojtje të rregullt dhe urdhërmbrojtje emergjente**

1. Kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente mund ta paraqesë:

1.1. Pala e mbrojtur;

1.2. Përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;

1.3. Mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;

1.4. Përfaqësuesi ligjor, kujdestari apo përfaqësuesi i Qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri, person me aftësi të kufizuara që i pamundëson parashtrimin e kërkesës, apo është person që i është hequr aftësia e veprimit;

1.5. OJQ-të që janë familjarizuar me problemin e viktimës dhe që kanë kapacitete për trajtimin e tyre.

#### **Neni 44**

#### **Kërkesa për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente**

1. Kërkesa për urdhërmbrojtje të rregullt ose urdhërmbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht dhe duhet të përmbajë:

1.1. Emërtimin e gjykatës;

1.2. Emrin, adresën dhe profesionin palës së mbrojtur dhe të palës përgjegjëse, përfaqësuesve ligjorë apo të autorizuar;

1.3. Marrëdhënia e palës së mbrojtur me palën përgjegjëse;

1.4. Përshkrimin në hollësi të gjendjes faktike dhe kur është e mundur duhet të bashkëngjis edhe provat, si dhe arsyen e kërkesës për shqiptimin e urdhrit mbrojtës ose urdhrit për mbrojtje emergjente;

1.5. Propozimin e masës mbrojtëse.

2. Nëse zbulimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të kërkuesit të palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente, do ta rrezikonte atë person, atëherë mund të merren një apo me tepër veprime, si më poshtë:

- 2.1. Kërkesa duhet të sigurojë një adresë alternative;
- 2.2. Adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës; ose
- 2.3. Nëse gjykata vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosjet në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.

#### **Neni 45**

#### **Shqyrtimi i kërkesave për urdhërmbrojtje të rregullt**

1. Gjkata shqipton urdhrin për mbrojtje me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, dhunës ndaj gruas dhe në baza gjinore mbrojtjen sigurinë dhe mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personave në marrëdhënie familjare me të.
2. Përmes këtij urdhri gjykata synon evitimin e pasojave dhe mënjanimin e rrethanave që ndikojnë apo mund të ndikojnë në përsëritjen e dhunës.
3. Gjkata vendos për kërkesën për urdhërmbrojtje brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës.
4. Për shqyrtimin e kërkesës për urdhërmbrojtje gjykata mban seancë në të cilën ftohen personat në vijim:
  - 4.1. Pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave;
  - 4.2. Pala përgjegjëse ose përfaqësuesi i autorizuar;
  - 4.3. Parashtruesi i kërkesës;
  - 4.4. Përfaqësuesi nga Qendra për punë sociale i komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:
    - 4.4.1. Parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose i mungon zotësia e veprimit.
  - 4.5. Dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.
5. Dëgjimi dhe shqyrtimi bëhet në mungesë të palës përgjegjëse, nëse i njëjti është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme gjithashtu shqyrtimi në mungesë të palës bëhet edhe në rastet kur adresa është e panjohur, është në arrati ose vendndodhja e tij është e panjohur.
6. Gjkata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas paragrafit 4 të këtij neni, në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.
7. Kërkesa konsiderohet e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë ftuar në mënyrën e rregullt, por nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre.
8. Tërheqja e kërkesës nuk e privon palën nga mundësia e paraqitjes së kërkesës tjetër për urdhërmbrojtje të rregullt.
9. Seancat e shqyrtimit në procedurën e lëshimit të urdhrin të rregullt mbrojtës janë të mbyllura për publikun.

**Neni 46****Shqyrtimi i kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente**

1. Gjykata shqipton urdhërmbrojtjen emergjente, me qëllim të parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore në rastet kur dyshon se në mungesë të kësaj mase, pala përgjegjëse paraqet rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur.
2. Gjykata pas pranimit të kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente vendos lidhur me të brenda njëzetekatër (24) orëve. Vendimin e merr gjyqtari individual pa mbajtur seancë gjyqësore dhe vetëm në bazë të materialit procedural të paraqitur në kërkesë dhe provave që janë dorëzuar në gjykatë.
3. Kundër vendimit për Urdhër mbrojtje emergjente palët kanë të drejtën e kundërshtimit në afat prej tre (3) ditëve.
4. Kur palët nuk e kundërshtojnë urdhrin për mbrojtje emergjente brenda afatit ligjor, i njëjti konsiderohet urdhërmbrojtje.

**Neni 47****Procedura sipas ankesës ndaj urdhrit të rregullt për mbrojtje**

1. Kundër urdhrit të rregullt për mbrojtje, mund të ushtrohet ankesë brenda afatit tetë (8) ditore nga dita e dorëzimit të vendimit.
2. Për ankesën kundër urdhrit mbrojtës vendos Gjykata e Apelit.
3. Parashtrimi i ankesës nuk ndalon ekzekutimin e urdhrit të rregullt mbrojtës.

**Neni 48****Procedura sipas kundërshtimit ndaj urdhrit për mbrojtjen emergjente**

1. Kundërshtimi kundër urdhrit për mbrojtje emergjente parashtrohet në gjykatën që ka vendos për urdhrin.
2. Parashtrimi i kundërshtimit nuk ndalon ekzekutimin e urdhrit mbrojtës emergjent.
3. Gjykata brenda afatit shtatë (7) ditëve pas parashtrimit të kundërshtimit cakton seancë dhe vendos për kundërshtimin në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.
4. Pas mbajtjes së seancës nga paragrafi 3 i këtij neni gjykata me vendim të veçantë e anulon vendimin me të cilin e ka caktuar urdhërmbrojtjen emergjente ose e zëvendëson me një tjetër vendim mbi caktimin e urdhërmbrojtjes në pajtim me nenin 51 të këtij ligji.
5. Kundër vendimit të gjykatës për zëvendësimin e urdhrit mbrojtës emergjent pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë.

**Neni 49****Përmbajtja e urdhrit mbrojtës të rregullt dhe urdhrit për mbrojtje emergjente**

1. Në urdhrin për mbrojtje dhe urdhrin për mbrojtje emergjente duhet të ceket:
  - 1.1. Masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata duke përcaktuar llojin e masës dhe mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhunshëm;
  - 1.2. Kohëzgjatja e urdhrit;



- 1.3. Udhëzimi juridik për të drejtën e ankesës gjegjësisht për kundërshtim;
  - 1.4. Njoftimin se shkelja ose mospërfillja e urdhrin mbrojtës është vepër penale;
  - 1.5. përcaktimin e qartë të detyrimeve për institucionet përkatëse për zbatimin e saj.
2. Vendimi për caktimin e urdhrin mbrojtës dhe për mbrojtje emergjente duhet të përmbajë urdhrin përmbarimor dhe ekzekutohet menjëherë.
  3. Vendimi për caktimin e urdhërmbrojtjes iu dërgohet menjëherë palës së mbrojtur, palës përgjegjëse, mbrojtësit të viktimave, Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë sociale dhe institucioneve të tjera relevante.
  4. Gjykata mund të urdhërojë policinë t'i dorëzoj palës përgjegjëse urdhrin për mbrojtje dhe urdhrin për mbrojtje emergjente.

#### **Neni 50**

#### **Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i Urdhrin mbrojtës**

1. Kur rrethanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose pala përgjegjëse mund t'i parashtrojë kërkesë gjykatës, për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje me ç' rast gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje:
  - 1.1. Të mbetet në fuqi;
  - 1.2. Të ndryshohet;
  - 1.3. Të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës.
2. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje, nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.
3. Pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të urdhrin për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje. Nëse kërkesa për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje nuk paraqitet 15 ditë para skadimit të afatit, e njëjta duhet të hedhet poshtë.
4. Nëse nuk parashtrohet kërkesa për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.
5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, gjykata mund:
  - 5.1. Të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa mbrojtëse.

#### **Neni 51**

#### **Ndryshimi dhe ndërprerja e urdhrin mbrojtës emergjent**

1. Gjykata mund të vendos për ndërprerjen e urdhrin mbrojtës emergjent me kërkesën e palës së mbrojtur dhe pas konstatimit nëse kanë pushuar shkaqet, mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri për mbrojtje emergjente.
2. Në rast të parashtrimit të kërkesës për ndryshimin e urdhrin mbrojtës emergjent, gjykata vendos përshtatshmërisht si në rastet e paraqitjes së kundërshtimit sipas nenit 48 të këtij Ligji.

## **Neni 52**

### **Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente**

1. Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës nga:

- 1.1. Pala e mbrojtur;
- 1.2. Përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;
- 1.3. Personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- 1.4. Përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur;
- 1.5. Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.

2. Kohëzgjatja e urdhrin të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme të punës së gjykatës.

3. Mbikëqyrësi Rajonal për Dhunë në Familje, ose shefi i Hetimeve të Stacionit Policor, ose të deleguarit e tyre mund të shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në nenet 29, 30, 31, 32, 33 dhe 39 të këtij ligji, nëse ai ose ajo vërteton se:

- 3.1. Ekzistojnë dyshimi i arsyeshëm se pala përgjegjëse ka kryer ose është kërcënuar se do të kryej ndonjë vepër të dhunës në familje;
- 3.2. Pala përgjegjëse paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje dhe,
- 3.3. Shqiptimi i urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

4. Kërkesa për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente mund t'i paraqitet Policisë së Kosovës edhe nga OJQ-të, që kanë informata të sigurta për dhunën e ushtruar dhe që janë familjarizuar me viktimën.

## **Neni 53**

### **Përmbajtja e urdhrin të përkohshëm emergjent**

1. Në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente duhet të ceket:

- 1.1. Masa e caktuar nga policia e Kosovës; kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, e cila skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon;
- 1.2. Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme është vepër penale;
- 1.3. Shpjegimi se pas kalimit të afatit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhërmbrojtje emergjente, e cila nëse lejohet, do t'i nënshtrohej mbajtjes së një seance apo paraqitjes së kërkesës për urdhërmbrojtje

kundër së cilës ushtrohet ankesë.

2. Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente i shqiptuar nga policia e Kosovës, duhet t'i dërgohet menjëherë palës përgjegjëse në familje në pajtim me ligjin.

3. Organet e zbatimit të ligjit u dërgojnë personave në vijim nga një kopje të urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente:

3.1. Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;

3.2. Parashtruesit të kërkesës;

3.3. Stacionit lokal të policisë në vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;

3.4. Qendrës për Punë Sociale në komunën ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;

3.5. Gjykatës kompetente; dhe

3.6. Mbrojtësit të viktimave apo përfaqësuesit të autorizuar.

4. Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente menjëherë pas shqiptimit nga ana e Policisë së Kosovës hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet ndaj palës përgjegjëse pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij.

#### **Neni 54**

#### **Shkelja e urdhrave mbrojtës**

1. Shkelja në tërësi ose pjesërisht e urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente përbën vepër penale të sanksionuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2. Përsëritja e vazhdueshme e shkeljes në tërësi ose pjesërisht e urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin e veprës.

3. Shkelja e urdhrin për mbrojtje, e urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, ndiqet sipas detyrës zyrtare.

4. Policia e Kosovës monitoron rregullisht dhe zbaton urdhrat mbrojtës të lëshuar nga organi kompetent, në varësi të shkallës së rrezikshmërisë në pajtim me vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut të përsëritjes së dhunës.

5. Policia e Kosovës ekzekuton urdhrat mbrojtës të lëshuar nga organi kompetent.

#### **Neni 55**

#### **Ndalimi i aplikimit të procedurave alternative**

Ndalohet aplikimi i procedurave alternative në procedurë penale dhe administrative për zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore, por duke mos u kufizuar në ndërmjetësim dhe pajtim.

### **Neni 56**

#### **Urdhrat e lëshuar nga vendet e tjera**

1. Urdhri mbrojtës i lëshuar nga një shtet tjetër, regjistrohet dhe hyn në fuqi nga gjykatat e Kosovës dhe zbatohet nga institucionet përkatëse sikurse të ishte i lëshuar në përputhje me këtë ligj.
2. Gjykata kryen regjistrimin e urdhrin mbrojtës të lëshuar nga një shtet tjetër duke u bazuar në dokumentet e mëposhtme:
  - 2.1. Kopje e certifikuar e urdhrin mbrojtës, dhe/apo;
  - 2.2. Një deklaratë të nënshkruar nga një zyrtar/e i/e gjykatës të shtetit tjetër prej të cilit urdhri është lëshuar, përmes së cilës vërtetohet se urdhri i lëshuar është ende në fuqi në ditën e certifikimit.
3. Gjykata ruan të drejtën të mbajë një kopje të certifikuar të urdhrin mbrojtës për efekte të regjistrimit.
4. Gjykata detyrohet që brenda 24 orëve t'i dërgojë një kopje të urdhrin mbrojtës policisë dhe të gjitha institucioneve të tjera përkatëse.

### **Neni 57**

#### **Mosnjohja e urdhrin mbrojtës i lëshuar nga shtetet e tjera**

1. Gjykatat mund të vendosin të mos e njohin urdhrin mbrojtës të lëshuar nga një vend tjetër në rastet kur:
  - 1.1. Në momentin e paraqitjes së kërkesës në gjykatën e Kosovës, urdhri mbrojtës nuk ka qenë i plotfuqishëm në shtetin ku është lëshuar, ose
  - 1.2. Në momentin e paraqitjes së kërkesës në gjykatat e Kosovës, ka skaduar afati i urdhrin mbrojtës;
  - 1.3. Masat mbrojtëse të përfshira në urdhrin mbrojtës të lëshuar nga shteti tjetër nuk janë të parapara në legjisllacionin në fuqi të Kosovës.

### **Neni 58**

#### **Kufizimi i lëshimit të urdhrave mbrojtës ndaj personave të shtyrë për kryerjen e dhunës**

1. Në përjashtim të ekzistimit të rrethanave të veçanta të cilat sipas gjykatës e bëjnë lëshimin e urdhrin mbrojtës të domosdoshëm, urdhrat mbrojtës nuk lëshohen kundrejt fëmijëve nën moshën 14 vjeç, personave të moshave të treta në kushte të shëndetit mendor që kufizon mundësinë e gjykimit të arsyeshëm dhe personave me aftësi të kufizuar, të cilët janë nxitur për të kryer dhunën.
2. Në rast të lëshimit të urdhrave mbrojtës kundrejt kategorive të përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata merr në konsideratë mirëqenien e tyre dhe vendos për:
  - 2.1. Caktimin e ndihmës juridike për t'i përfaqësuar gjatë procedurave në gjykatë;
  - 2.2. Caktimin e kujdestarisë dhe kujdesit përkatës nga ofruesit e shërbimeve sipas nevojave të palës përgjegjëse, që u përkasin grupeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

**Neni 59****Marrëdhëniet e viktimës dhe palës së mbrojtur me punëdhënësit**

1. Viktimat e dhunës në familje dhe palët e mbrojtura, kanë të drejtë të marrin 15 ditë kalendarike leje të paguar, për të adresuar problemet shëndetësore, ligjore, ndërrim të vendbanimit, për veten apo për personat e varur prej tij/saj.
2. Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të kërkojnë deri në një vit pushim pa pagesë për adresimin e problemeve shëndetësore që janë pasojë e drejtpërdrejtë e dhunës së përjetuar.
3. Punëdhënësit kanë të drejtë të kërkojnë nga punonjësit e tyre, viktimat të dhunës në familje, dokumente prove për ditët e shpenzuara për adresimin e problemeve shëndetësore, ligjore, ndërrimin e vendbanimit, etj.
4. Viktimave iu garantohet ruajtja e vendit të punës pa pagesë deri në një vit, vetëm nëse i/e punësuar/e viktimë e dhunës në familje ka qenë e punësuar në vendin e punës për jo më pak se 12 muaj.

**Neni 60****Masat Mbrojtëse ndaj Azilkërkuesve, Imigrantëve dhe Punëtorëve të Huaj Viktima të dhunës në familje dhe ndaj grave**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen pa paragjykim dhe në mënyrë të njëjtë për azilkërkuesit, imigrantët dhe punëtorët e huaj, dhe anëtarët e familjes së tyre që gjenden në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Në rast se pala e mbrojtur e ka përfutur leje qëndrimin apo rezidencën e përkohshme apo kërkesën për dhënie të statusit të azilit në territorin e Republikës së Kosovës përmes aplikimit të palës përgjegjëse, organet kompetente e shqyrtojnë aplikimin për leje qëndrim të palës së mbrojtur, ndarazi nga aplikimi apo lënda e palës përgjegjëse.

**Neni 61****Detyrimi për mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave**

1. Ministria përkatëse në fushën e drejtësisë krijon dhe mirëmban sistemin elektronik për menaxhimin e informacionit - evidentimin e rasteve të dhunës në familje, dhe dhunës ndaj grave i cili mbikëqyret dhe mirëmbahet nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për fushën e drejtësisë.
2. Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga dhuna në Familje dhe Grupi Koordinues vendos për krijimin, ndryshimin, plotësimin dhe zgjerimin e sistemit të integruar të të dhënave.
3. Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime në rastet e dhunës në familje, kanë për obligim që brenda 24 orëve të regjistrojnë të dhënat në bazën e të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës.
4. Ministria përkatëse për fushën e drejtësisë nxjerr udhëzim administrativ me të cilin përcakton mënyrën e mirëmbajtjes, sigurisë dhe përdorimit të sistemit dhe nxjerrjen e raporteve publike duke siguruar konfidencialitetin për viktimën.

## **KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 62 Zbatimi**

1. Gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj.
2. Për lëndët për të cilat ka filluar procedura gjyqësore para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
3. Për të gjitha çështjet procedurale që nuk janë të rregulluara me këtë Ligj vlejné dhe zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

### **Neni 63 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

### **Neni 64 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-185  
21 shtator 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-164/2023, datë 09.10.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**